



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.162, datë 11.09.2019

PËR

**SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z. {...}
NGA PROCEDURAT E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative”.*

2. Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.*

3. Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë

Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale”.

4. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurat e konkurimit për tre pozicionet e lira të shpalluara përmes vendimeve mësipër.

5. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë” (pika 1). Po me këtë vendim (pika 2, nëndarja 6), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidatin, z{...}, është caktuar si relator z.Illir Toska.

6. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për: - fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

7. Brenda afatit treditore, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njesuar me origjinalin), relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

9. Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidatit formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.

11. Më datë 06.08.2019, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua përsëri për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, konkretisht për të evidentuar në mënyrë të qartë përvojën profesionale si avokat, profesor ose lektor i të drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, si dhe për të plotësuar dokumentacionin provues të përvojës së tij profesionale në këto fusha, duke iu lënë afat deri më datë 04.09.2019, duke mbajtur në konsideratë qenien në atë moment në muajin gusht, pra në periudhën e pushimeve vjetore të administratës shtetërore, por edhe asaj private, çka mund t'i krijonte kandidatit vështirësi për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm provues të përvojës profesionale.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, relatori i çështjes kërkoi informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figures, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për z.Daci.

13. Nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati u konstatua edhe fakti i punësimit të tij si “këshilltar për marrëdhëniet me Parlamentin i Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë” gjatë periudhës Shtator 2014 - Shtator 2015, pra gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

13.1 Fakti i punësimit të kandidatit si “këshilltar për marrëdhëniet me Parlamentin i Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë” gjatë periudhës Shtator 2014 - Shtator 2015, pasqyrohej në Jetëshkrimin e dorëzuar nga ai.

13.2 Po ashtu, një fakt i tillë, pasqyrohej edhe në kopjen e njesuar me origjinalin të dokumentit “Librezë Pune”, dorëzuar nga kandidati.

13.3 Gjithashtu, në formularin e Deklaratës “Për mosmbajtjen e funksioneve politike në administratën publike”, plotësuar dhe dorëzuar nga kandidati, deklarohet se:

“Nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

Theksoj, që pozicioni që unë kam mbajtur si “Këshilltari ligjor dhe për marrëdhëniet me Parlamentin i Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë”, në vlerësimin tim nuk vlerësohet si funksion politik në kuptim të Kushtetutës së RSH dhe nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por është vetëm emërtesë “politike” e Ministrisë dhe nuk ka përfshirë asnjë funksion të karakterit politik sikurse ka patur për qëllim ligjvënësi duke marrë në konsideratë edhe faktin që nuk kam patur asnjë të drejtë vendimmarrje etj”.

14. Po ashtu, në Jetëshkrimin e kandidatit pasqyrohej si punësim edhe ai i “këshilltarit ligjor pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës”, sipas Kontratës CS/CQ/NO.7-2011, për periudhën Janar 2012 - Qershor 2012, pra gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

15. Marrë shkas nga dy faktet e punësimit si më lart të kandidatit, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës

së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes kërkoi informacion dhe dokumentacion për punësimin e kandidatit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (me Shkresën nr. 3946/3 prot.) dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (me Shkresën nr. 3946/4 prot.).

16. Në përgjigje të kërkesës, me Shkresën nr. 14851/1 prot., datë 20.08.2019, (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3946/6 prot., datë 22.08.2019), Ministria e Financave dhe Ekonomisë informoi se: “... arkivi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, disponon aktet e emërimit dhe lirimit për periudhën shtator 2014 - shtator 2015, kur Z.Daci ka mbajtur funksionin Këshilltar i Ministrit të Financave”.

16.1 Bashkëngjitur kësaj shkrese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar kopje, të njësuar me origjinalin, të aktit të emërimit dhe të lirimit nga detyra të z. {...}.

16.1.1 Konkretisht, Shkresa nr. 12835 prot., datë 19.09.2014, e Ministrit të Financave, me Subjekt: Emërim, ka këtë përmbajtje:

“Në bazë të Ligjit Nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Pozita Juridike e Funkionarëve Politik;

Z. {...}, emërohet Këshilltar për Marrëdhëniet me Parlamentin, në Kabinetin e Ministrit të Financave.

*Paga mujore e funksionarit politik përbëhet nga : ...
Marrëdhëniet financiare i fillojnë më datë 18.09.2014”.*

16.1.2 Ndërsa Shkresa nr. 12613/1 prot., datë 14.09.2015, e Ministrit të Financave, me Subjekt: Lirim nga Detyra, ka këtë përmbajtje :

*“Në bazë të Ligjit Nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Pozita Juridike e Funkionarëve Politik, z. {...}, me detyrë Këshilltar i Ministrit të Financave, lirohet nga kjo detyrë me kërkesën e tij për dorëheqje.
Marrëdhëniet financiare i ndërpriten më datë 18.09.2015”.*

17. Po ashtu, në përgjigje të kërkesës, në lidhje me faktin e punësimit si “këshilltar ligjor pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës”, me Shkresën nr. 7318/1 prot., datë 13.08.2019, (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3946/5 prot., datë 14.08.2019), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informoi se: “... z. {...} nuk figuron në regjistrat themeltar të ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE)”.

18. Pas të dhënave të grumbulluara në lidhje me faktin e punësimit si “këshilltar për marrëdhëniet me Parlamentin, në Kabinetin e Ministrit të Financave”, për periudhën Shtator 2014 - Shtator 2015, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 2, shkronja “b” në lidhje me nenin 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi vlerësimin se në rastin konkret verifikohej një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se

kandidati nuk plotësonte një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, relatori i çështjes vuri në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, me Vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që: *“Kandidati z. {...}të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”*.

19. Mbi këtë bazë, më datë 29.08.2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

20. Brenda afatit pesëditor, me datë 03.09.2019, në rrugë elektronike, por edhe fizikisht në zyrën e prokurorit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar edhe si Këshilli), kandidati paraqiti shpjegimet e tij.

21. Nga ana tjetër, brenda afatit të caktuar, më datë 04.09.2019, kandidati depozitoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në lidhje me evidentimin në mënyrë të qartë të përvojës së tij profesionale si avokat, profesor ose lektor i të drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, si dhe dokumentacionin provues të kësaj përvoje.

22. Në shpjegimet e tij, ndër të tjera, kandidati pretendonte për një përmbajtje, të ndryshme nga ajo e cituar në rastin e njoftimit të gjetjes së procedurës së verifikimit, të nenit 2, shkronja “b” dhe nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përmbajtje referuar të cilës pretendonte se ky ligj nuk zbatohet vetëm për ministrin përgjegjës për administratën publike dhe nëpunësit e kabinetit të tij, domethënë jo për çdo ministër dhe nëpunës kabinetit të ministrit, përfshirë dhe Ministrin të Financave, këshilltar i të cilit ai kishte punuar. Marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga kandidati në shpjegimet e tij, si dhe duke patur parasysh se në ndonjë publikim elektronik të ligjit të përditësuar si më lart përmbajtja e dy dispozitave në fjale ishte sipas asaj çka kandidati pretendonte, në funksion të një verifikimi sa më të plotë të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, më datë 04.09.2019, relatori i çështjes kërkoi një interpretim/opinion ligjor nga organi i publik, i pavarur, përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil, në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim.

23. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me Shkresën nr. 1436/1 prot., datë 06.09.2019 (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4327/1 prot., datë 06.09.2019), Komisioneri për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil, pas një analize të legjislacionit në fuqi për administratën shtetërore, në interpretimin/opinionin e tij ligjor ka arritur në përfundimin se: *“... pozicioni këshilltar në kabinetin e ministrit, në çdo ministri, gëzon statusin e funksionarit politik, i cili përjashtohet nga shërbimi civil sipas nenit 2, “Fusha e veprimit”, gërma “gj” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”*.

23.1 Në këtë rast, Komisioneri për Mbikqyrjen në Sherbimin Civil ka cituar edhe përmbajtjen e nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konkretisht si vijon: *“Funksionarë i kabinetit” është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit”.*

24. Më datë 06.09.2019, në rrugë elektronike, relatori i çështjes njoftoi kandidatin për interpretimin/opinionin ligjor të dhënë nga Komisioneri për Mbikqyrjen në Sherbimin Civil, duke e ftuar për të paraqitur ndonjë shpjegim shtesë në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

25. Më datë 09.09.2019, në rrugë elektronike, kandidati paraqiti shpjegime shtesë në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

26. Pas marrjes edhe të shpjegimeve shtesë nga kandidati, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohej një rrethanë faktike dhe ligjore e aftë për të passjell skualifikimin e kandidatit nga procedurat e emërimit, relatori i çështjes ia parashittoi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

19. Në Mbledhjen e datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ

1. Referuar dokumentit “Librezë Pune” në lidhje me të dhënat e punësimit të plotësuar nga Ministria e Financave, Shkresës nr. 14851/1 prot., datë 20.08.2019, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Shkresës nr. 12835 prot., datë 19.09.2014, të Ministrit të Financave dhe Shkresës nr. 12613/1 prot., datë 14.09.2015, të Ministrit të Financave, verifikohej fakti se kandidati, z. {...}, ka qenë i punësuar, gjatë 10 vjeteve të fundit para kandidimit, në detyrën e “këshilltarit në Kabinetin e Ministrit të Financave”, funksion ky i klasifikuar nga ligji si funksion politik.

2. Sipas nenit 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ***“Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.***

3. Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ***“Kandidatët jogjqtarë për pozicione në Gjykatën e***

Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

4. Sipas nenit 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **“Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskrye-ministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës-kryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit”.**

5. Nisur nga fakti që vërtetohet, si dhe në referim të ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se për kandidatin, z. {...}, vërtetohet se nuk plotëson një nga kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve), atë të përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b” në lidhje me nenin 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përderisa rezulton që ai të ketë mbajtur një funksion politik në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit, pikërisht funksionin e “këshilltarit në Kabinetin e Ministrit të Financave”.

6. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të rregullta dhe të plota procedurat e verifikimit të ndjekura deri në këtë moment për z. {...}, në veçanti verifikimet sa i përket këtij kushti kandidimi.

III. PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE

1. Në shpjegimet e tij, kandidati, z. {...}, ka parashtruar:

“1. Së pari, kjo nuk ishte një gjetje, pasi këtë gjë unë ua kam bërë të ditur si në kërkesën për kandidim, ashtu edhe në jetëshkrim, në librezën e punës, në kërkesat për plotësim dokumentacioni, në deklaratën nëse kisha mbajtur apo jo pozicione publike etj. Kësisoj, marrja e dokumenteve nga Ministria e Financave, sikurse janë akti i emërimit dhe akti i lirimit nga detyra, nuk mund të konsiderohen gjetje në zbatim të vendimit të KLGJ dhe vetë procedurës së verifikimit.

2. Ndërkohë, lidhur me arsyetimin për këtë “gjetje”, qëndrimi im është si vijon:

2.1 Së pari, referenca në shkresat e Ministrit të Financave për emërimin dhe lirimin tim nga detyra, është bërë gabimisht në ligjin Nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil në RSH”, i ndryshuar, pasi në atë kohë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Prandaj, edhe referenca juaj në këtë ligj dhe përfshirja e përkufizimit të tij porsa i përket “Funksionarëve politik”, është e gabuar dhe nuk mund të ketë vlerë juridike, pasi ky ligj as nuk ka qenë në fuqi kur jam emëruar dhe jam liruar nga detyra dhe nuk është as sot në fuqi. Referenca gabim nga ana e Ministrit nuk i jep fuqi këtij ligji dhe përkufizimeve të tij në lidhje me kërkesën time dhe plotësimin e kriterëve që ka caktuar ligji për emërimin si anëtar të Gjykatës së Lartë.

2.2 Së dyti, ju i referoheni në arsyetimin tuaj, germës ç), të pikës 1 të nenit 4, të ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në fakt, ndryshe ngase arsyetoni ju, në dallim nga ligji i mëparshëm, ky ligj bën një ndarje të ndryshme midis funksioneve që i përkasin

kategorisë së nëpunësve civil dhe atyre jo civil, duke mos pasur si kritere dallimi funksionin politik ose civil, por duke bërë midis të tjerash, edhe përjashtimin e veprimit të këtij ligji në një tërësi pozicionesh që nuk lidhen në radhë të parë me funksione politike. Për më tepër referuar përmbajtjes literale të germës ç), të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 2 të këtij ligji, ky ligj, lidhur me funksionarin e kabinetit i referohet vetëm kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji. Pra në këtë rast, ky ligj përjashton zbatimin e tij vetëm për kabinetin e ministrit që është përgjegjës për administratën publike dhe jo për çdo ministri duke përfshirë Ministrinë e Financave ku unë kam punuar. Ky kuptim del nga pika 1 e nenit 7 të këtij ligji, i cili saktëson se: "1. Departamenti i Administratës Publike përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për administratën publike.". Ndërkohë, që aktualisht prej disa vitesh duke përfshirë vitet 2014 dhe 2015, Ministri përgjegjës për administratën publike është "Ministri i Brendshëm".

Po ashtu, ndryshe nga ligj i mëparshëm, ky ligj nuk përkufizon dhe nuk përfshin shprehimisht në përmbajtjen e tij, përkufizimin e funksionarit politik dhe as nuk përcakton as shprehimisht dhe as tërthorazi, pozicionin e Këshilltarit të Ministrit të Financave si "funksion politik". Gjithsesi, si ligji Nr. 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil në RSH", i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar) ashtu edhe ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" bëjnë një ndarje midis funksioneve politike dhe atyre jo politike jo për qëllime të ushtrimit të funksioneve politike, por vetëm për efekte të emërtesës dhe jo natyrës së detyrës që ato ushtrojnë, duke pasur si qëllim të vetëm shmangien e zbatimit të normave për nëpunësit civil në emërimin dhe lirin e tij nga detyra etj. Në të njëjtën linjë dhe kuptim është edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 893, datë 17.12.2014, gjithashtu i cituar nga ana juaj.

Pra porsa më lartë, përfundimi juaj se "Sa më lart, referuar legjislacionit në fuqi në momentin e emërimit tuaj si këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave, por edhe atij gjatë kohëvazhdimin të ushtrimit të kësaj detyre nga ana juaj, "funksioni i këshilltarit në kabinetin e ministrit" është përcaktuar si "funksion politik në administratën publike", është i gabuar dhe i pambështetur si në këtë ligj ashtu edhe në ndonjë normë tjetër juridike ligjore në fuqi në RSH. Ky arsyetim, është i saktë po të kemi parasysh që në këtë rast, interpretimi juaj bëhet në kuadër të një dispozite e cila ka për qëllim kufizimin e të drejtës time për të kandiduar mbi bazën e pasjes ose jo të një funksioni të mëparshëm politik në 10 vitet e fundit. Kësisoj, interpretimi në radhë të parë nuk mund të çojë në krijimin e një norme të re juridike të paqenë, sikurse praktikisht lë të nënkuptojë interpretimi juaj dhe në radhë të dytë, interpretimi për qëllime të kufizimit të një të drejtë në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, në lidhje edhe me nenet 3, 4, 5, 116, 122 të Kushtetutës së RSH, nuk lejohet porsa kohë norma nuk e përmban atë qartazi dhe shprehimisht, pasi kufizimi duhet të jetë i parashikuar shprehimisht në një ligj dhe nuk mund të vijë si pasojë e një interpretimi. Kjo gjë do të cënonte në thelb këtë garanci kushtetuese timen dhe parimin themelor të së drejtës "In claris non fit interpretatio" duke përfshirë parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ju ushtroni atributet e ligjvënësit nëpërmjet krijimit praktikisht një normë të re juridike. Mbi të njëjtin arsyetim, kufizimi i të drejtës time për të kandiduar, duhet të bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit ose drejtpeshimit të mishëruar po

në nenin 17 të Kushtetutës dhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky kufizim sipas këtij parimi duhet të bëhet vetëm duke respektuar kushtet si vijojnë¹:

- 1. Kufizimi duhet të bëhet vetëm me ligj.*
- 2. Masat duhet të ndërmerren jo mbi baza diskriminuuese.*
- 3. Masat duhet të justifikohen nga nevojat e interesit të përgjithshëm.*
- 4. Masat duhet të jenë të përshtatshme për të përmbushur objektivat që ata synojnë.*
- 5. Masat nuk duhet të shtrihen përtej nevojës për të përmbushur objektivin e synuar (Me fjalë të tjera, ndërhyrja duhet të jetë e nevojshme për një shoqëri demokratike).*

Në rastin konkret, ky kufizim i dalë nga një interpretim i tillë, çënon në thelb këtë parim themelor kushtetues pasi:

1) Nuk bëhet i bazuar në një ligj.

2) Bëhet mbi baza diskriminuuese, pasi 'inter alia', Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk e ka cilësuar si funksion politik, pozicionin e Këshilltarit të Presidentit të Republikës, porsa i përket z. {...}, fakt ky i bërë i njohur botërisht. Kësisoj, një kriter nuk mund të zbatohet ndryshe për një person sikurse për mua, kur në fakt ligji përcakton se vepron vetëm ndaj ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ndryshe ndaj një personi tjetër sikurse atij që ka mbajtur postin e Këshilltarit të Presidentit, ndërkohë që Institucioni i Presidentit të Republikës shprehet saktësisht në ligj dhe Ministri i Financave nuk shprehet fare. Nga ana juaj, mund të arsyetohen që jeni dy institucione të ndryshme, por ky fakt nuk do ta zhbënte diskriminimin e pastër në raport me mua dhe këdo tjetër në pozitën time.

3) Interpretimi juaj në favor të kufizimit dhe vetë kufizimi ashtu sikurse ju arsyetoni, nuk justifikohet nga nevojat e interesit të përgjithshëm, pasi nuk synon të përmbushë asnjë interes legjitim në kuptim edhe të dispozitës Kushtetuese, konkretisht të pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës. Në asnjë rast, ky nen nuk mund të kuptohet i shkëputur nga parimet e përgjithshme themelore kushtetuese ose nenet 3, 4, 5, 7, 17 dhe neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës.

4) Interpretimi dhe kuptimi që ju i jepni ligjit konkretisht përkufizimit që ka bërë ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në germën ç) të nenit 3 të tij, haptazi bie ndesh me pikën 4 të nenit 136 të Kushtetutës. Konkretisht, pika 4, e nenit 136 të Kushtetutës dhe shumë nene të tjera të kushtetutës, janë ndryshuar dhe kanë hyrë në fuqi në vitin 2016, kohë në të cilin legjislacioni i përmendur nga ana juaj ka qenë në fuqi me përjashtim të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Nga ana tjetër, kjo normë (neni 136) përmban një rezerve absolute kushtetuese duke saktësuar midis të tjerash se "4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së

¹ Shiko midis të tjerash, vendimet e GJEDNJ për rastet: "Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar 1976", "Jahn dhe të tjerit kundër Gjermanisë 1999, 2001", "Ish Mbreti i Greqisë dhe të tjetër kundër Greqisë 1994" dhe vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në rastin "Gebhard" (1995) etj.

gjqtarit parashikohen me ligj." Pra Kushtetuta nuk ka autorizuar nxjerrjen e ndonjë normë ligjore për të përkufizuar së gfarë do të thotë "Funksion politik në administratën publike", por vetëm nxjerrjen e normave për përcaktimin e kriterëve të tjera ligjore. Pra germa ç) e nenit 3 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është nxjerrje në shkelje të rezervës absolute kushtetuese, pasi nuk ka përcaktuar vetëm kriteret e tjera, por edhe ka përkufizuar "funksionin politik në administratën publike". Nga ana tjetër, kuptimi i funksioneve politike sipas frymës së kushtetutës dhe qëllimi i pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës është për të bërë të mundur mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të ndalimit ose parandalimit të ndikimit të interesave politike në sistemin gjyqësor duke nënkuptuar në këtë mënyrë garantimin dhe ruajtjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si vazhdimësi e parimit themelor kushtetues të ndarjes së pushteteve të mishëruar në nenin 7 të Kushtetutës. Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar si organe dhe funksione politike vetëm organet dhe funksionet kushtetuese që zgjidhen ose emërohen sikurse janë, Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave, zëvendësministri, anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, Kryetarët e njësive të Pushtetit Vendor dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, në kuptimin e përgjithshëm doktrinar, funksione politike ushtrohen çdo organ i çdo pushteti shtetëror i cili merr pjesë në ushtrimin e pushtetit shtetëror të RSH. Në këtë kuptim edhe pozita e gjyqtarit, është në vetvete një formë e politikëbërjes pasi gjyqtari në këtë rast merr pjesë në ushtrimin e pushtetit shtetëror gjyqësor të RSH. Pra ndarja që i referohen ligjet e përmendura nga ana juaj, përveçse porsa theksoj më lartë, bëhet vetëm për qëllime të ndarjes së kriterëve për zgjedhjen, emërimin ose lirimin nga detyra dhe jo për të bërë një ndarje midis funksioneve politike dhe jo politike sipas pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës së RSH. Nga ky këndvështrim, çdo përkufizim dhe arsyetim ligjor apo interpretues bie ndesh si me përmbajtjen ashtu edhe me frymën dhe qëllimin e Kushtetutës së RSH dhe nuk është i nevojshëm për një shoqëri demokratike.

2.3 Së fundmi edhe pse germa ç) e nenit 3 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është nxjerrje në shkelje të rezervës absolute kushtetuese, përsëri kjo gërmë përcakton ndryshe ngase arsyetoni ju, konkretisht sikurse vijon:

"ç) "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit".

Nisur nga formulimi i kësaj germe, në lidhje edhe me fjalinë e pikës 1 të këtij neni "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:" është e qartë se nga pikëpamja gjuhësore jemi para një fjalie të përbërë me një pjesë kryesore "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:" dhe me dy pjesë të nënrenditura sikurse janë:

Pjesa e parë: "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit," dhe

Pjesa e dytë: "që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit."

Në rastin tonë, pra edhe pse jemi para një formulimi të keq nga pikëpamja gjuhësore, përsëri në kuptimin që del nga interpretimi gjuhësor si interpretimi më origjinal dhe i drejtë i normës, kuptohet që funksione politike janë funksionet e "Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, zëvendësministrit ose nëpunësit, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit. Në rastin tim, unë nuk kam pasur asnjë nga këto funksione. Në pjesën e parë, koha e foljes është e kryer e tejshkuar në formën mohore. Ndërkohë, në rastin e variantit të dytë, i shprehur në pjesën e dytë të nënrenditur, folja është në kohën e tashme "që kryen", çfarë nënkupton, që as ky variant në rastin tim nuk vlen, pasi unë nuk kryej funksionin e këshilltarit të ministrit të financave që nga 18 shtatori 2015.

Nga ana tjetër, në arsyetimin tuaj, është përdorur teksti i germës "ç)" duke i hequr ose injoruar presjen pas togfjalëshit "ose ministrit", ... duke çuar në këtë mënyrë në një kuptim krejtësisht të ndryshëm të fjalisë dhe duke e shndërruar atë nga një fjali e përbërë me dy pjesë të nënrenditura, në një fjali të përbërë me një pjesë të nënrenditur. Gjithsesi, referenca në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 6 ("Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit"), është përcaktuar se "1. Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme: ...; ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ... gjatë 10 viteve të fundit; ..." është korrekte dhe në fakt i ky ligj i qëndron besnik Neni C, të aneksit të Kushtetutës që ka një përcaktim të njëjtë me nenin 136 të Kushtetutës porsa i përket kriterit të mospasjes së funksionit politik.

Përfundimisht, vlerësoj që funksioni i Këshilltarit të Ministrit të Financave nuk përbën funksion politik sipas kuptimit të nenit 49 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi 'midis të tjerash' nuk përbën një funksion të vërtet në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit si nga pikëpamja politike ashtu edhe ajo administrative. Kjo për shkak se këshilltari nuk ka të drejtë firme, nuk përfaqëson institucionin në asnjë rrethanë dhe nuk merr asnjë lloj vendimi. Praktikisht, këshilltari ekziston vetëm për qëllime të ndihmës ndaj titullarit dhe jo për ndonjë person tjetër të tretë. Në rastin konkret, unë kam pasur detyrën e këshilltarit juridik dhe të atij për marrëdhëniet me Parlamentin. Kjo gjë del qartazi nga përshkrimi i detyrave që kam pasur, dokument i cili gjendet në arkivin e Ministrisë së Financave. Pra, unë jo vetëm që nuk kam ushtruar funksion politik, por përkundrazi, funksioni im ka qenë këshillimi për të respektuar ligjin dhe kushtetutën; pra për të kufizuar veprimin politik të ministrit brenda kufijve ligjor dhe kushtetues".

2. Ndërsa në shpjegimet shtesë, kandidati, z. {...}, ka parashtruar:

"Me anë të postës elektronike, me datë 6 shtator 2019, më është njoftuar vendimi juaj "Për marrjen e një interpretimi/opinionit ligjor nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim", si dhe mendimi i marr. Lidhur me këtë vendim dhe mendimin e marr, brenda afatit prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes, dëshiroj t'ju shpjegoj si vijon:

1. Vendimi juaj për të kërkuar një interpretim/ opinion ligjor nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim, është në kundërshtim të hapur me statusin kushtetues të KLGJ-së dhe çënon pavarësinë e këtij organi kushtetues që garantohet nga neni 147 në lidhje edhe me nenin 147/a të Kushtetutës së RSH. Pavarësia e një institucioni në raport

me vendimmarrjen e tij nuk nënkupton vetëm ndalimin e ndërhyrjes së organeve të tjera në vendimmarrje, por edhe në ndalimin e ndikimit në çdo lloj mënyrë në vendimmarrjen e këtij institucioni dhe në bindjen e secilit prej anëtarë. Marrja e një mendimi nga një organ tjetër që nuk e parashikon kushtetuta, përbën drejtpërdrejtë ndërhyrje në pavarësinë e këtij institucioni, pasi çdo mendim apo interpretim përbën formë ndikimi në vendimmarrje. Në fakt, referuar neneve 147, 147/a dhe 134 të Kushtetutës, KLGJ mund të kërkojë mendim vetëm nga Gjykata Kushtetuese, të cilës mund t'i drejtohet me kërkesë në përputhje me 131 të Kushtetutës së RSH. Çdo institucion tjetër nuk mundet as tërthorazi dhe as drejtpërdrejtë të përzihet apo të shfaqë mendime qoftë edhe me kërkesë të KLGJ, në lidhje me çështje në kuadër të vendimmarrjes së KLGJ.

2. Edhe nëse marrja e mendimit do të vlerësohej e ligjshme, përsëri kërkimi i mendimi dhe vetë mendimi i dhënë nuk ka asnjë kuptim, porsa kohë, ju i kërkon mendim këtij institucioni për veprimtari dhe persona të cilat nuk i ka objekt të punës. Konkretisht, referuar nenit 14 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ky institucion nuk ka kompetencë as të jap mendim për KLGJ ose ndonjë institucion tjetër dhe as të merret me interpretimin në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim. Në këtë këndvështrim lind pyetja; si mund të jap mendim dhe të merret në konsideratë një mendim për diçka që një institucion nuk ka asnjë kompetencë dhe nuk ka asnjë njohuri të thelluar mbi këtë çështje? Gjithashtu, unë nuk kam pretenduar asnjëherë të kem qenë nëpunës civil, por thjesht pretendoj që në kuptim të nenit 136/4 të Kushtetutës dhe germës ç) të nenit 3 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk kam ushtruar ndonjëherë ndonjë funksion politik dhe nuk kam ndalim për të kandiduar.

3. Interpretimi ligjor nuk është çështje institucionale më shumë sesa çështje njohurish të thelluara shkencore dhe profesionale. Në rastin konkret, referuar edhe mendimit të dhënë, rezulton të jetë një mendim i cili nuk ka kuptuar drejtë as përmbajtjen e vetë ligjit, pasi referuar përmbajtjes literale të germës ç), të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 2 të këtij ligji, ky ligj, lidhur me funksionarin e kabinetit i referohet vetëm kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji. Pra në këtë rast, ky ligj përjashton zbatimin e tij vetëm për kabinetin e ministrit që është përgjegjës për administratën publike dhe jo për çdo ministri duke përfshirë Ministrinë e Financave ku unë kam punuar. Ky kuptim del nga pika 1 e nenit 7 të këtij ligji, i cili saktëson se: "1. Departamenti i Administratës Publike përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për administratën publike.". Ndërkohë, që aktualisht prej disa vitesh duke përfshirë vitet 2014 dhe 2015, Ministri përgjegjës për administratën publike është "Ministri i Brendshëm". Këtë fakt, lehtësisht të kuptueshëm, dhënësi i mendimit e injoron ose nuk e kupton siç duhet, pasi ligji nuk zbatohet në këtë rast për çdo ministri, por vetëm për ministrinë që është përgjegjës për administratën publike, që është Ministria e Brendshme.

4. Së fundmi sikurse edhe e kam theksuar në shpjegimet e paraqitura më shkrim para jush, edhe nëse kuptimi i legjislacionit të referuar nga ana juaj, do të ishte sikurse arsyetoni ju, përsëri theksoj që në kohën kur unë jam emëruar këshilltar i ministrit, ushtrimi i këtij funksioni nuk përbënte ndalim për të kandiduar për anëtar të Gjykatës së Lartë sipas legjislacionit të kohës. Pra legjislacioni në fuqi, nuk më kërkonte mua të bëj një kujdes të veçantë lidhur me

këtë aspekt, në kohën kur u emërova. Ndërkohë, Kushtetuta e RSH dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, ndalon fuqinë prapavepruese të ligjit i cili cenon të drejta të fituara apo shkakton pasoja mbi marrëdhënie të lindura përpara hyrjes në fuqi të një ligji. Kjo nënkupton që ndalimi nuk mund të ketë efekt ndaj meje, porsa kohë në kohën e emërimit nuk përbënte ndalim dhe mua nuk më kërkohet të bëja kujdes në raport me ambiciet e mia për të konkurruar në këtë pozicion në të ardhmen, sikurse kam bërë aktualisht. Një zbatim i tillë është i ndaluar nga Kushtetuta pasi cenon parimet themelore kushtetuese duke përfshirë sigurinë juridike në raport me të drejtat e fituara më parë dhe pasojat që vijnë nga veprimet ose mosveprimet e kryera në një kohë të mëparshme për të cilat ligji i kohës nuk kishte penalizime. Me fjalë të tjera, zbatimi i ndalimit në rastin konkret, përbën edhe një lloj dënimi pa ligj ndaj meje për veprime të kryera në kohën e mëparshme, për të cilat ligji nuk parashikonte dënime në formën e ndalimeve sikurse ligji aktual.

5. Unë mendoj që lidhur me gjykimin e kësaj çështje, fakti që edhe ju i keni kërkuar mendim një institucioni tjetër (edhe pse në vlerësimin tim nuk duhej bërë një gjë e tillë), tregon që ekziston një paqartësi mbi kuptimin e shprehjes “Nuk ka ushtruar funksione politike... në rastin e Këshilltarit të Ministrit të Financave”. Në fakt, sikurse kam shpjeguar edhe më parë, gjykoj që i vetmi ligji që KLGJ duhet t’i referohet, është ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kushtetuta e RSH. Në këtë pikëpamje, nëse KLGJ ka paqartësi apo nuk është e sigurt mbi kuptimin kësaj shprehje, në cilësinë edhe të një personi që ka shprehur interes për kandidim, ju kërkoj t’i drejtoheni Gjykatës Kushtetuese në përputhje me germën ë) të nenit 134 dhe germës a) të nenit 131 dhe pikës 1 të nenit 124 të Kushtetutës, me kërkesë me objekt “Interpretimin e pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së germës ç) të nenit 3 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me Kushtetutën e RSH në lidhje edhe me nenet 3, 4, 5, 15, 17, 18, 116 dhe 122 të saj dhe përputhjen e kësaj germe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, konkretisht me nenet 1, 7, 18 të saj”. Interpretimi nga Gjykata Kushtetuese është i domosdoshëm sidomos nëse i referohemi edhe arsyetimit të bërë nga ana ime në pikën 4 të kësaj shkresë.

6. Porsa më lartë, në lidhje me këtë çështje, kërkoj që ky mendim të mos merret parasysh dhe KLGJ të mos marr mendime të tjera dhe të mos ndikohet nga asnjë person ose institucion tjetër, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, në çdo rast, përpara se të merrni një vendim përfundimtar mbi këtë çështje, në respektim të së drejtës time për proces të rregullt, kërkoj që të dëgjohem personalisht nga KLGJ para se ju të shpreheni me vendim”.

3. Në Mbledhjen e datës 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrtoi paraprakisht kërkesën e kandidatit për t’u degjuar personalisht, parashtruar ne rastin e shpjegimeve shtesë, duke vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Në këtë rast Këshilli vlerësoi se shqyrtimi nga ai i çështjeve në përgjithësi, përfshirë edhe për ato në lidhje me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Lartë, zhvillohet mbi bazë dokumentesh të administruara gjatë procedurës së verifikimit. Nga ana tjetër, në lidhje me respektimin e elementeve të parimit të procesit të rregullt ligjor, në veçanti të të drejtës së kandidatit për t’u dëgjuar gjatë procedurës së verifikimit, në aktin nënligjor (Vendimin 75/2019) nxjerr në zbatim të ligjit, është rregulluar edhe mënyra e ushtrimit të kësaj të drejte, duke u parashikuar e drejta e kandidatit për të paraqitur shpjegime (në format me shkrim ose elektronik) për gjetjen e procedurës së verifikimit të njoftuar rregullisht atij, përpos edhe të çdo dokumentacioni mbështetës. Në rastin konkret, gjate procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kandidatit, z. {...}, i është garantuar

e drejta për t'u dëgjuar, duke iu dhënë atij mundësia, në dy raste, për të paraqitur shpjegimet e tij rreth gjetjes së procedurës së verifikimit, përveç edhe të çdo dokumentacioni mbështetës sipas vlerësimit të tij.

4. Në vijim dhe konsieratë të arsyetimit më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar pretendimin e kandidatit se gjetja e procedurës së verifikimit njoftuar atij nuk ishte “gjetje” meqënëse faktin e punësimit të tij si “këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave” ai e kishte bërë vetë të ditur në dokumentacionin e kandidimit. Këshilli vlerëson se kandidati ka një kuptim të ndryshëm të konceptit “gjetje të procedurës së verifikimit” sipas Vendimit 75/2019, gjë e cila në vetvete nuk nënkupton thjesht një fakt të caktuar, por një fakt të rëndësishëm për procedurën e verifikimit, vërtetimi i të cilit, shoqëruar me një analizë ligjore të ligjit të zbatueshëm, ka aftësinë të passjell/prodhojë një pasojë/efekt të caktuar në procedurën e verifikimit të atij kandidati. Nisur nga kjo, Këshilli vlerëson se kandidati në rastin konkret është njoftuar për faktin e vërtetuar përmes dokumenteve zyrtarë (deklaruar paraprakisht edhe prej tij), sikundër ai është njoftuar edhe për analizën ligjore të këtij fakti, elemente këto që së bashku formojnë “gjetjen e procedurës së verifikimit”, gjetje kjo e cila mund të passillte skualifikimin dhe përjashimin e kandidatit nga procedurat e emërimit ku ai ka kandiduar. Nga ana tjetër, duke u njoftuar për “gjetjen e procedurës së verifikimit”, siç dhe u parashtrua, Këshilli vlerëson se kandidatin i është siguruar e drejta për t'u dëgjuar në një procedurë administrative, pra e drejta për të dhënë shpjegime rreth gjetjes së kësaj procedure me pasoja të mundshme për të drejtat e tij, sikundër kandidatin i është dhënë mundësia për të paraqitur çdo dokumentacion mbështetës për pretendime eventuale të tij.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar në ligj pretendimin e kandidatit se funksioni që ai ka mbajtur si “këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave”, nuk ka qenë funksion politik në momentin e emërimit të tij në këtë detyrë, sikundër vijon të mos jetë i tillë.

5.1 Për pabazueshmërinë e këtij pretendimi të kandidatit, Këshilli ka në konsideratë se klasifikimi si funksion politik i funksionit të “këshilltarit të kabinetit të ministrit” është përcaktuar shprehimisht nga ligji, neni 2, shkronja “ç”, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5.2 Nga përmbajtja e nenit 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se ligjvënësi ka konsideruar tërësisht, pa asnjë përjashtim, çdo rregullim të legjislacionit ndër vite (prej vitit 1996), përmes të cilit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, janë bërë përcaktime për funksionarët politikë dhe/ose funksionet politike, ku ndër to, përveç funksionit të “ministrit”, përfshihet edhe funksioni i “këshilltarit të ministrit” apo “këshilltarit në kabinetin e ministrit”.

5.3 Në lidhje me legjislacionin ndër vite, Këshilli ka parasysh përcaktimet e bëra në nenin 13² (“Funksionarët politikë”), Kreu II (“Pozita juridike e funksionarëve politikë”), nenin 15³ dhe në Shtojcën Nr.1⁴ (“Lista e funksionarëve politikë që janë objekt i ligjit “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”), Kreu IV (“Në Ministri”), të Ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5.4 Po ashtu, Këshilli ka parasysh edhe përcaktimet e bëra në nenin 4⁵ (“Organet dhe institucionet e administratës shtetërore”), në nenin 11⁶ (“Struktura e ministrisë”), në nenin 17⁷ (“Kabinetet”) dhe në nenin 30⁸ (“Periudha kalimtare dhe aktet nënligjore”), Kreu VII (“Dispozitat kalimtare”), të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

² **“Funksionarët politikë, për të cilët zbatohen dispozitat e këtij ligji, janë të gjithë personat që ushtrojnë funksione drejtuese politike në organet qendrore dhe lokale të administratës publike, titullarë dhe zëvendës të tyre në institucionet publike të specializuara, si dhe personat që ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike të personave të lartpërmendur”.**

³ **“Postet e strukturës organizative të shërbimit civil që do të zihen nga funksionarë politikë, paraqiten sipas shtojcës 1 të bashkëlidhur”.**

⁴ **“1. Ministër; ... 4. Anëtarët e kabineteve të funksionarëve të mësipërm, të cilët kanë kabinete, ku hyjnë: shefat e kabineteve, këshilltarët, ndihmësit, zëdhënësit pranë kabineteve dhe sekretarët personal”.**

⁵ **1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore. 2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione: a) Kryeministria; b) ministrinë; c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave; ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve; d) agjencitë autonome; dh) administrata e prefektit. 3. ...”.**

⁶ **1. Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion. Ministria organizohet në këto struktura organizative hierarkike: a) sekretari i përgjithshëm; b) drejtoritë e përgjithshme; c) drejtoritë; ç) sektorët. Departamentet janë struktura organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë. 2. Ministri mund t’ua delegojë autoritetin e tij funksionarëve politikë dhe nëpunësve të lartë civilë të ministrisë për plotësimin e detyrave funksionale. 3. ... 4. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror. 5. ...”.**

⁷ **“1. Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit. 2. ...”.**

⁸ **“1. Këshilli i Ministrave miraton apo, përkatësisht, propozon, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndryshimet në legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore,**

5.5 Lidhur me legjislacionin ndër vite, Këshilli ka parasysh gjithashtu edhe përcaktimet e bëra në pikat 5, 6 dhe 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” (dalë në zbatim të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”)⁹.

5.6 Në lidhje me klasifikimin si funksion politik të “këshilltarit të ministrit” apo “këshilltarit në kabinetin e ministrit”, Këshilli ka parasysh edhe rregullimet e bëra në nenin 1¹⁰ (“Objekti”), në nenin 3¹¹ (“Kryeministria “), në nenin 4¹² (“Struktura dhe përbërja”), në nenin 7¹³ (“Ministria”) dhe në nenin 30¹⁴ (“Ankimi ndaj akteve”), të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

për përshtatjen e tyre me dispozitat e këtij ligji. 2. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, siç kërkohet në dispozitat përkatëse, veçanërisht në pikën 5 të nenit 16, në pikën 2 të nenit 17, në pikën 8 të nenit 20, në pikën 5 të nenit 21 dhe në pikën 5 të nenit 24 të këtij ligji”.

⁹ **“5. Strukturat organizative për kryerjen e funksioneve administrative në institucionet e administratës shtetërore veçojnë në përmbajtjen e tyre tri nivele: - Funksionarë politikë; - Nëpunës civilë; - Punonjës administrativë. 6. Funksionarët politikë në ministrinë e linjës organizohen brenda kabinetit të ministrit. 7. Kabineti drejtohet nga drejtori i kabinetit, i cili përgjigjet para ministrit dhe nuk është pjesë e hierarkisë administrative. / Kabineti përbëhet nga: a) këshilltarët, që emërohen nga ministri. ...”.**

¹⁰ **“Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe”.**

¹¹ **“1. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit. 2. ...”.**

¹² **“1. Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit. ... 3. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i të punësuarve të kabineteve, bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e kryesuesit të kabinetit. Te punësuarit e kabineteve gëzojnë statusin e funksionarit politik”.**

¹³ **“1. Ministria është person juridik, publik, që përfaqësohet dhe drejtohet nga ministri. Ministria mbështet, në aspektin teknik, veprimtarinë e ministrit. ... 5. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i funksionareve politike të ministrisë bëhet me urdhër të ministrit”.**

¹⁴ **“... 2. Subjektet, që gëzojnë statusin e funksionarit politik, nuk kanë të drejtë të paraqesin ankime kundër aktit të ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror në varësi të Kryeministrit, me pretendimin se u është cenuar një e drejtë ose interes i ligjshëm”.**

5.7 Së fundi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka parasysh edhe përcaktimet e bëra në nenin 2¹⁵ (“Fusha e veprimt” dhe në nenin 4¹⁶ (“Përkufizime”), të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014.

5.8 Nga tërësia e përcaktimeve si më lart në legjislacionin ndër vite, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është tërësisht e qartë se funksioni i “këshilltarit të ministrit” apo “këshilltarit në kabinetin e ministrit”, për çdo ministër, për një periudhë mbi 20-vjeçare, është klasifikuar dhe vijon të klasifikohet si funksion politik në administratën shtetërore, pjesë e administratës publike në Republikën e Shqipërisë.

5.9 Për qenien e kandidatit funksionar politik në rastin e kryerjes së detyrës së “këshilltarit në Kabinetin e Ministrit të Financave”, vlen të mbahet në konsideratë edhe vlerësimi dhe qëndrimi i organit të emërtesës, pra Ministrit të Financave. Në mënyrë evidente, nga procesi i ndjekur dhe referenca ligjore e përdorur nga Ministri i Financave për rekrutimin e kandidatit në funksionin e “Këshilltarit të kabinetit”, duket që për organin e emërtesës, emërimi dhe lirimi nga detyra i z. {...}, është bërë për një funksion politik.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të gabuara citimet nga kandidati të përmbajtjes së nenit 2, shkronja “b” dhe nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, sikundër edhe pretendimet e tij të ngritura mbi këtë bazë.

6.1 Ndryshe nga sa kandidati pretendon, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se nga fusha e zbatimit të këtij ligji (Ligjit 152/2013) nuk përjashtohet vetëm ministri përgjegjës për administratën publike, por çdo ministër, që si edhe ministri përgjegjës për administratën shtetërore, janë, sipas ligjit, ndër funksionarët më të lartë politikë në administratën shtetërore. Të pranosh të kundërtën, sikurse kandidati pretendon, do të thotë të pranosh se ky ligj zbatohet për të gjithë ministrat, me përjashtim të ministrit përgjegjës për administratën shtetërore. Thënë kjo, do të thotë të pranosh se ministrat, me përjashtim të ministrit përgjegjës për administratën shtetërore, trajtohen si nëpunës civil të administratës shtetërore, çka është një pohim i papranueshëm ligjërish përse kohë ministrat janë ndër funksionarët më të lartë politikë në administratën shtetërore, që vijnë në këtë funksion

¹⁵ “Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim të: a) të zgjedhurve; b) ministrit dhe zëvendësministrit; ...; gj) funksionarit të kabinetit; ...”.

¹⁶ “1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, **ministritë**, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. ... ç) “Funksionar i kabinetit” është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, **ministrit**, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, **këshilltarit**, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit. ...”.

përmes një procesi qartësisht politik. Në rrjedhje të kësaj, nga fusha e zbatimit të këtij ligji (Ligji 152/2013) përjashtohet edhe çdo nëpunës pjesë e kabinetit të çdo ministri pa përjashtim, nëpunës ky që kryen edhe detyrën e këshilltarit të kabinetit të ministrit, sikurse ka kryer dhe kandidati në rastin konkret.

6.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se, nga sa duket, kandidati, në citimin e dispozitave si më lart të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet t’i jetë referuar ndonjë publikimi të përditësuar të ligjit, ku janë reflektuar në mënyrë të pasaktë ndryshimet dhe shtesat e bëra me Ligjin nr. 178/2014. Në këtë të fundit, në nenin 4 të tij, është përcaktuar *se “Kudo në ligj emërtimet “ministri” ose “Ministria e Brendshme” zëvendësohen me emërtimin “ministri përgjegjës për administratën publike”*, por ky përcaktim nuk ka prekur rregullimet fillestare të neneve 2 dhe 4 të Ligjit 152/2013, sikundër pretendohet indirekt nga kandidati. Nga kërkimi në internet konstatohet se një publikim i tillë me pasaktësi në përmbajtjen e këtyre dy dispozitave është edhe ai, bërë në Janar 2015, nga Qendra e Botimeve Zyrtare, pikërisht botimi “Përmbledhëse për nëpunësin civil”. Ligjërisht, publikimet e ndryshme të legjislacionit, përfshirë edhe i përmbledhëseve të legjislacionit të përditësuar, sipas tematikës, nga Qendra e Botimeve Zyrtare, nuk përbën botim zyrtar. Sipas Ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare” (neni 6), “1. Fletorja Zyrtare është i vetmi botim zyrtar, në formatin e shtypur dhe elektronik, në të cilin gjendet i pasqyruar teksti i aktit të botueshëm në versionin përfundimtar të tij, pas procedurës së miratimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. 2. Në Fletoren Zyrtare botohen: a) ligjet; ...”. Gjithsesi, ndodhur para kësaj situatë, gjatë procedurës së verifikimit, përmes relatorit të çështjes, siç dhe u parashtrua, është kërkuar dhe marrë një interpretim/opinion ligjor nga Komisioneri për Mbikqyrjen në Sherbimin Civil, organ publik, i pavarur, përgjegjës për mbikqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim, pra edhe për periudhën kur Ligji 152/2013 ka pësuar ndryshime dhe shtesa me Ligjin 178/2014. Në përgjigjen e tij, siç dhe u parashtrua, Komisioneri për Mbikqyrjen në Sherbimin Civil, ka konfirmuar edhe përmbajtjen e saktë të nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përmbajtje kjo e ndryshme nga sa kandidati pretendon dhe që i është bërë atij prezent në rastin e njoftimit për gjetjen e procedurës së verifikimit.

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuar edhe pretendimin e kandidatit se Ligji 152/2013 dhe Ligji 90/2012, *“bëjnë një ndarje midis funksioneve politike dhe atyre jo politike jo për qëllime të ushtrimit të funksioneve politike, por vetëm për efekte të emërtesës dhe jo natyrës së detyrës që ato ushtrojnë, duke pasur si qëllim të vetëm shmangien e zbatimit të normave për nëpunësit civil në emërimin dhe lirin e tij nga detyra etj”*.

8.1 Në fakt, Ligji 90/2012, sa i përket nëpunësve pjesë të kabinetit të ministrit, ku përfshihen dhe këshilltarët, në mënyrë të shprehur dhe pa asnjë ekuivok ka përcaktuar se ata kanë statusin e funksionarëve politikë në administratën shtetërore, e cila, nga ana tjetër, është pjesë e administratës publike.

8.2 Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, sikurse pretendon kandidati, nuk përmban rregullime të shprehura drejtpërdrejt për “funksionarët politikë”. Por, ndryshe nga sa pretendon kandidati, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se edhe ligji pararendës për nëpunësin civil, pra Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, nuk ka përmbajtur rregullime të kësaj natyre. Pozita

juridike e funksionarëve politikë, prej vitit 1996, pra edhe gjatë periudhës kur në fuqi ka qenë Ligji 8549/1999, është rregulluar nga një ligj tjetër, pikërisht Ligji nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 8300, datë 02.03.1998 (Kreu II).

8.3 Ndërkohë, Ligji 152/2013, duke patur për qëllim rregullimin e marrëdhënies juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil, pra marrëdhënien e shërbimit civil, indirekt, përmes përjashtimeve të shprehura nga fusha e zbatimit të tij, ka përcaktuar, ndër të tjerë, edhe “funksionarët politikë”, funksionarë këta të cilët, sa i përket administratës shtetërore, janë përcaktuar në mënyrë të shprehur në ligje të tjera të veçantë, siç është dhe Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Në këtë ligj, sa i përket nëpunësve pjesë të kabinetit të ministrit, ku përfshihen edhe këshilltarët, sikurse u përmend, në mënyrë të shprehur është përcaktuar se ata kanë statusin e funksionarëve politikë në administratën shtetërore.

8.4 Thënë sa më lart, ligji për nëpunësin civil, qoftë ai i vitit 1999, ashtu dhe ai i vitit 2013, kanë patur për qëllim rregullimin e marrëdhënies së shërbimit civil, duke përcaktuar dhe funksionet për nëpunësit civil, ndërkohë që indirekt, përmes përjashtimeve nga fusha e veprimit të tyre, ato kanë përcaktuar edhe funksionet për nëpunësit “jo civil”, ku përfshihen dhe funksionarët politikë, të cilët janë përcaktuar me ligje të tjera të veçanta.

8.5 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se përcaktimi i bërë në nenin 17, pika 1, të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, është e pamundur të injorohet mbi arsyetimin se bërja e këtij përcaktimi nuk ka qenë qëllimi i ligjit, ndërkohë që ligji ka përcaktuar edhe natyrën e detyrave, përfshirë dhe të këshilltarëve të kabinetit të ministrit, pikërisht në mbështetje të drejtpërdrejt të ministrit për ndjekjen e politikave përkatëse, për realizimin e objektivave, si dhe për vlerësimin e zbatimit të tyre. Fakti që nëpunësit e kabinetit të ministrit, përfshirë dhe këshilltarët, nuk kanë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror, ndryshe nga sa kandidati pretendon, nuk mund të çojnë në përfundimin se ata nuk janë funksionarë politikë. Përkundrazi, sipas ligjit, ata janë të tillë, por pa patur këto kompetenca, të cilat ligji ua ka dhënë funksionarëve më të lartë politikë në administratën shtetërore, ndër ta edhe ministrit, në mbështetje të drejtpërdrejt të të cilit këshilltarët ushtrojnë funksionin këshillues të tyre, funksion ky i ligjshëm, por gjithsesi politik. Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, “KËSHILLTAR I m. sh. 1. Ai që jep këshilla, ai që këshillon dikë, këshillues. 2. Ai që është caktuar pranë një institucioni, një organizate etj. për të dhënë mendimin për çështje të ndryshme dhe për të ndihmuar me këshilla në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore a shtetërore. ...”. Në rastin konkret, vetë emërtimi i pozicionit tregon qartë natyrën e detyrave që mbulon këshilltari, duke u kufizuar në dhënien e mendimeve dhe opinioneve drejtuesit të institucionit, konkretisht Ministrit të Financave, por kjo nuk mund të konsiderohet si mungesë e karakterit politik të këtij pozicioni/funksioni.

9. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se përfshirja e nëpunësit, pjesë e kabinetit të ministrit, që kryen detyrën e këshilltarit, në përmbajtjen e nenit 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është një rastësi apo kapërcim nga ligjvënësi i legjislacionit të deriatëkohshëm, por, përkundrazi, një rikonfirmim nga ai i funksioneve politike, shoqëruar me shfaqjen e vullnetit të tij për të mos lejuar promovimin në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor (Gjykatën e Lartë) të asnjë funksionari politik, që ka mbajtur funksione të tilla gjatë 10 vjetëve të fundit, para kandidimit për këtë post.

10. Në kontekst të këtij përfundimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar pretendimin e kandidatit për cënim të sigurisë juridike si rrjedhojë e përcaktimit të bërë në nenin 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sa i përket përfshirjes në koncepti e funksionit politik të “këshilltarit të kabinetit të ministrit”.

10.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kufizimi i vendosur në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për personat që kanë mbajtur funksione politike, nuk cënon parimin e sigurisë juridike përsa kohë koncepti i “funksionit politik” apo “funksionarit politik” nuk është përcaktuar për herë të parë në këtë ligj, por, siç u parashtrua, ky koncept ka qenë i parashikuar qartësisht edhe më parë në legjislacionin e 20 viteve të fundit. Në kohën kur kandidati ka kryer detyrën/funksionin e “këshilltarit të Ministrit të Financave”, siç dhe u parashtrua, ka pasur një parashikim të qartë ligjor për “funksionarin politik”. Ky fakt, në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është tejet i rëndësishëm, pasi mjafton për të rrëzuar pretendimin për cënim të sigurisë juridike, përderisa për kandidatin ka qenë e qartë se, sipas ligjit në fuqi, duke kryer detyrën e “këshilltarit të ministrit”, ai po ushtronte një funksion politik, ndërkohë që nuk është Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ai që jep zgjidhje për herë të parë për këtë çështje.

10.2 Në lidhje me pabazueshmërinë e pretendimit të kandidatit për cënim të sigurisë juridike, Këshilli i Lartë Gjyqësor mban në konsideratë edhe jurisprudencën kushtetuese, sipas të cilës:

Siguria juridike, si koncept kushtetues, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ. “Parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë ose dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qartë, të përcaktuar dhe të kuptueshëm”¹⁷. Sipas këtij parimi, normat juridike duhet të jenë të formuluar qartë dhe në harmoni ndërmjet tyre;

“Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi”¹⁸;

“... parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike”¹⁹;

¹⁷ Vendimi nr. 34, datë 20.12.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁸ Vendimi nr. 36, datë 15.10.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁹ Vendimi nr. 26, datë 02.11.2005 dhe Vendimi nr. 37, datë 13.06.2012, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

“Jo çdo masë me efekte negative që merr ligjvënësi për subjektet e ligjit është cenim i një të drejte të garantuar me Kushtetutë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta, të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme, nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi”²⁰;

Parimi i sigurisë juridike në praktikë realisht sintetizohet nga parimi i pritshmërive legjitime, ndërsa ky i fundit “merr inerci” nga prekja e të drejtave të fituara dhe/ose nga efektet retroaktive të ligjit (në kuptimin formal dhe material). Pritshmëria legjitime, sikundër interpretohet në doktrinën e të drejtës kushtetuese dhe administrative, përfshin parimin e mbrojtjes së të drejtave të fituara dhe parimin e vazhdimësisë/konsistencës së ligjit, në kuptimin material të tij;

“Parimi i pritshmërisë legjitime është aspekt i shtetit të së drejtës që kërkon rregullsi, parashikueshmëri dhe siguri në veprimtarinë e shtetit kundrejt personave. Që të ngrihet çështja e pritshmërisë legjitime, vendimet e organit shtetëror duhet të kenë efekt mbi personin, duke e privuar nga ndonjë përfitim të cilin ai ose: a) e ka gëzuar në të kaluarën me lejen e shtetit dhe mund të presë në mënyrë legjitime që ta gëzojë, derisa t’i njoftohet ndonjë arsye publike për t’ia hequr atë; ose b) ka marrë sigurinë nga shteti se ky përfitim nuk do i hiqet pa i dhënë më parë mundësinë të paraqesë arsye për kundërshtimin e tij. ... Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kushtetuta nuk ndalon çdo ndryshim të një situate të favorshme ligjore. Kështu, në këtë drejtim, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku, besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t’u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese, si dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai nuk mund të prekë ato të drejta, kufijtë e të cilave në Kushtetutë janë parashikuar shprehimisht si të pakapërcyeshme ose të kufizueshme vetëm në raste specifike. Të drejtat e tjera kushtetuese ai mund t’i kufizojë vetëm në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, pra, për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës. Për sa i përket masave të tjera që merr ligjvënësi, qofshin edhe ato me efekte negative për subjektet e ligjit, nuk mund të pranohet se kufizimi i tyre sjell në çdo rast cenimin e parimit kushtetues të mbrojtjes së të drejtave të fituara (shih vendimin nr. 41, datë 09.05.2007, të Gjykatës Kushtetuese)”²¹.

10.3 Thënë sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se përfshirja në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e bëra në vitin 2016 (me Ligjin 76/2016), në kuadër të reformës në drejtësi, e kufizimit të të drejtës për t’u emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë për ata persona që, në 10 vitet e fundit para kandidimit, kanë mbajtur funksione politike në administratën publike, ka patur për qëllim shmangien e ndikimit politik në sistemin gjyqësor në funksion të garantimit të pavarësisë së organit më të lartë të pushtetit gjyqësor dhe rritjen e besimit të publikut sa i përket integritetit dhe imazhit të anëtarëve të këtij organi, pra për një interes të lartë publik. Ky kufizim nuk çënon parimin e sigurisë juridike në rastin konkret, ndryshe nga sa kandidati pretendon, përse kohë ai nuk e ka fituar ndonjëherë këtë të drejtë, për të pretenduar se Kushtetuta i ka cënuar pritshmëritë legjitime, që sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese nënkupton më së pari “të drejtat e fituara”, të cilat, nga ana tjetër, duhet të kenë efekte financiare tërësisht në favor të

²⁰ Vendimi nr. 10, datë 19.03.2008 dhe Vendimi nr. 37, datë 13.06.2012, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

²¹ Vendimi nr. 11, datë 06.03.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

qytetarit, ku anulimi ose ndryshimi i tyre në përkeqësim do të rezultojë në një humbje konkrete dhe të menjëhershme, pra jo një humbje potenciale në të ardhmen, në dëm të qytetarit. Përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, kandidati nuk plotësonte kriteret formale sipas ligjit të kohës²² për t'u emëruar në pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ku për këtë mjafton fakti se ai është diplomuar jurist vetëm në Qershor 2002, që do të thotë se ai nuk ka patur minimalisht 15 vjet përvojë profesionale. Përveç kësaj, e drejta për të klandiduar mund të lind vetëm kur hapet gara, pra kur ka një pozicion të lirë dhe organi i ngarkuar nga ligji shpall procedurën përkatëse të emërimit. Në rastin konkret një gjë e tillë ka ndodhur vetëm në Korrik 2019, pra gati 3 vjet pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të ritheksojë se, përveç Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është akti themeltar juridik më i lartë i shtetit shqiptar, Kushtetuta, ajo që, në nenin 136, pika 4, ka përcaktuar si kusht për emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, atë të “të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”. Parashikimi i kushtit kushtetues sipas kësaj dispozite edhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të përbëjë shkak për të vënë në diskutim dhe, për më tepër, për të arritur në përfundimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të kësaj dispozite ligjore, përse kohë ky rregullim është përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë, ndërsa ligji i veçantë thjesht ka ripërsëritur atë.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se nuk mund të vihet në diskutim kushtetueshmëria e shkronjës “ç”, të nenit 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi, ndryshe nga sa kandidati pretendon, përcaktimi i kuptimit të termave të përdorur në këtë ligj nuk ka nevojë për delegim të veçantë nga Kushtetuta, përveç se, kuptimi i dhënë në këtë rast për nocionin “funksione politike në administratën publike”, sikurse dhe me lart u parashtrua, është i njëjtë me legjislacionin e vecantë të fushës. Për rrjedhojë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se nuk qëndron pretendimi i kandidatit për kufizimin pa ligj të të drejtës së tij për të kandiduar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë ky kufizim është bërë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila nuk ka bërë ndonjë dallim ose përjashtim për funksionet dhe funksionarët politikë në administratën publike, duke lënë nën përgjegjësinë e ligjvënësit përcaktimin e kuptimit të saj, me qëllim bërjen të zbatueshëm të rregullimit kushtetues. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është evidente se ky kufizim kushtetues është vendosur pikërisht për atë që pranohet edhe nga kandidati, pra për të shmangur ndikimet politike në sistemin gjyqësor me qëllim garantimin e pavarësisë së organit më të lartë të pushtetit gjyqësor dhe rritjen e besimit të publikut sa i përket integritetit dhe imazhit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pra për një qëllim që i përgjigjet interesit publik të mirëadministrimit të drejtësisë.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuar pretendimin e kandidatit se rregullimi i bërë në shkronjën “ç”, të nenit 2, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është nxjerrje në shkelje të rezervës absolute kushtetuese.

²² Ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar.

13.1 Në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës parashikohet se *“Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”*.

13.2 Referuar doktrinës kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin e “rezervës ligjore absolute” është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënie konkrete, ndërsa në rastin e “rezervës ligjore relative”, çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore.

13.3 Duke ardhur në rastin konkret, fjalia e dytë e pikës 4, të nenit 136, të Kushtetutës është rasti i “rezervës ligjore absolute”, sepse nëpërmjet delegimit që Kushtetuta i bën ligjvënësit i ka dhënë pushtet të përcaktojë, krahas kriterëve dhe procedurave kushtetuese edhe kriterë e procedura të tjera ligjore për këtë kategori kandidatësh që vijnë nga radhët e jogjyqtarëve. Për këtë mjafton t’i referohesh në rastin konkret Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga mund të evidentohet pushteti që kushtetutbërësi i ka dhënë ligjvënësit për të shkuar edhe tej formulimeve që Kushtetuta parashikon. Është e kuptueshme që Kushtetuta nuk mund të parashikojë çdo gjë, ndaj ajo përcakton parimet themelore, jep standardin, si dhe orienton mbi konceptin kushtetues që duhet të respektojë ligjvënësi.

13.4 Në rastin konkret, kushtetutbërësi ka parashikuar atë sa mund të parashikohet nga Kushtetuta, por jo më shumë se formulimi që *“Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”*. Pikërisht, mosmbajtja e funksionit politik është qëllimi i normës kushtetuese, ndërkohë që kush përfshihet në “funksionin politik” është çështje e ligjit dhe brenda konceptit të rezervës ligjore absolute. Nëse ligjvënësi nuk do të parashikonte në mënyrë më të hollësishme se çfarë është “funksioni politik” dhe kush përfshihet në këtë kategori funksionesh, atëherë me formulimin kushtetues që përmend vetëm termin “funksion politik” do ishte e pamundur të qartësohej ajo që duhej të zbatohet në praktikë.

13.5 Në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ligjvënësi nuk ka abuzuar me delegimin kushtetues përse kohe nuk konstatohet që të ketë kapërcyer duke zgjeruar konceptin që Kushtetuta parashikon. Kështu, në këtë kuptim, termi “funksion politik”, ashtu si në çdo legjislacion demokratik, nuk e përjashton funksionarët e pushtetit ekzekutiv dhe, në veçanti, ministrin. Në rrjedhojë të kësaj, ndërsa është e njohur dhe e gjithëpranuar se në stafin e ngushtë, kabinetin e ministrit është dhe këshilltari, atëherë edhe ky i fundit klasifikohet si pjesë e konceptit të “funksionit politik”.

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të papranueshëm pretendimin e kandidatit për zbatimin ndaj tij, mbi baza diskriminuese, të kushtit skualifikues nga kandidimi të përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke referuar për këtë në një vendimmarrje të një organi tjetër kushtetues (Këshillit të Emërimeve në Drejtësi), për lejimin e kandidimit të një kandidati për një funksion të caktuar (Inspektor i Lartë i Drejtësisë).

14.1 Pavarësisht pretendimit për diskriminim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati, në thelb, nuk referon ndonjë menyrë të vepruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të orientuar mbi

paragjykime të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore të tij, sikurse përcaktohet në nenin 18, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

14.2 Përkundrazi, kandidati, përmes këtij pretendimi, në thelb kërkon që Këshilli i Lartë Gjyqësor të trajtojë dhe zgjidh rastin e tij njëlloj sikundër ka vepruar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në një rast që ka qenë për shqyrtim përpara këtij organi kushtetues. Pra, kandidati në fakt kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor respektimin e parimit të barazisë para ligjit, sipas nenit 18, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, *“parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”*. Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke konsideruar ligjërisht të papranueshme dhe të pabazuar pretendimin e kandidatit, vlerëson se çdo organ i administratës publike ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë së tij, të respektojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet dhe aktet e tjera normative në fuqi. Vendimi i një organi publik nuk është i detyrueshëm për organet e tjera publike, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj. Në rastin konkret, kandidati nuk evidenton ndonjë qëndrim të ndryshëm të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë veprimtarisë së tij, në kuadër të zbatimit nga ai të funksionit të tij kushtetues të përcaktuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, atë të propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, funksion për ushtrimin e të cilit Këshilli ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të respektojë legjislacionin përkatës të miratuar për këtë qëllim, pikërisht Kushtetutën (nenin 136) dhe Ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Së fundi, shpjegimet e tij (shpjegimet shpesh) kandidati i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që nëse ka paqartësi apo nuk është e sigurt mbi kuptimin e shprehjes *“nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike”* të përdorur në pikën 4, të nenit 136, të Kushtetutës, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e kësaj dispozite, si edhe për vlerësimin e përputhshmërisë së shkronjës “ç”, të nenit 2, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

15.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuar kërkesën e kandidatit që Këshilli t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e pikës 4, të nenit 136, të Kushtetutës. Së pari, Këshilli nuk ka ndonjë paqartësi për këtë dispozitë. Së dyti, Këshilli vlerëson se, referuar dispozitave kushtetuese të përmendura nga kandidati (neni 124, pika 1, neni 131, shkronja “a” dhe neni 134, shkronja “ë”), sikundër referuar edhe Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016, Këshilli vlerëson se Gjykata Kushtetuese vërtetë bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, por se këtë ajo tashmë mund ta bëjë vetëm në kuadër të shqyrtimit të një mosmarrëveshje kushtetuese. Pra, asnjë subjekt, përfshirë edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk mund t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese bërjen e një interpretimi abstrakt të një norme të Kushtetutës.

15.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuar edhe kërkesën e kandidatit që Këshilli t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për pajtueshmërinë me Kushtetutën të shkronjës "ç", të nenit 2, të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Sikundër dhe më lart u parashtrua, në vlerësim të Këshillit, kjo dispozitë ligjore nuk çmohet e papajtueshme me Kushtetutën dhe ajo nuk cënon veprimtarinë e tij kushtetuese, kërkesa këto të nenit 49, pika 3, shkronja "ç", të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar²³. Për më tepër, nisja e një procesi përpara Gjykatës Kushtetuese nuk është detyrim, por një e drejtë e organit inicues, kur ai vlerëson se çështja është në juridiksioni e kësaj gjykate.

IV. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati, z.Daci, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të "të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit", përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 2, shkronja "b" në lidhje me nenin 2, shkronja "ç", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ai ka konkurrar.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat, përsa kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm kandidimi passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën "b", pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën "ç", të nenit 2, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në shkronjën "a", pika 2, të nenit 61, në shkronjën "a", të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në shkronjën "e", pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, Vendimin

²³ "3. Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe: ...; ç) Këshilli i Lartë Gjyqësor ..., kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve; ...".

nr. 109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR